



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.23/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr. 5/2017, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahiu-Kërveshi, Përmbaruesi Privat dhe në mungesë të ftuar me rregull për seancë Albulena Uka nga Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, me datën 21.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-05/2017 i datës 05.09.2023, si i pa bazuar.

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr. 05/2017.

## Arsy e t i m

Me datën 05.09.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbarruesit privat, lidhur me veprimet përmbarrimore P.nr.05/2017, pas raportit të inspektimit, nr.08/2023 me datën 04.09.2023.

Përmbarruesi Privat, në seancën dëgjimore ka theksuar se ankesa për fillimin e procedurës disiplinore është parashtruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara sipas nenit 375 të LPP-së.

I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar duke ngjellur pranë inspektimit të raportit, nr.08/2023 të datës 04.09.2023, përkatësisht përgjigjes, të paraqitur me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhë në përfundim që Përmbarruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, pasi vlerësoi pretendimet e paraqitura në raport të inspektimit të lartcekur gjeti se inicimi i kësaj procedure është parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor me nenin 375 të LPP-së, sepse veprimet e fundit përmbarrimore nga ana e përmbarruesit privat janë ndërmarrë me datën 11.06.2021. Nga kjo rezulton të jetë se inicimi i procedurës është paraqitur për më tepër se një vit nga dita kur janë ndërmarrë veprimet e fundit përmbarrimore në rastin përmbarrimor P.nr.05/17. Kjo nga shkakun se sipas dispozitës së cekur më lart, është përcaktuar afati ligjor për iniciimin e procedurës disiplinore nga 6 muaj, por jo më vonë se 1 vit nga dita e shkeljes së pretenduar, për këto arsye komisioni nuk u lëshua më tej në vlerësimin se përmbarruesi privat ka bërë apo nuk ka bërë veprime përmbarrimore për të cilat është iniciuar procedura, të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**

DPL.nr 23/2023 datë 21.11.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushë Karaçi



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.